

Fehari RAMADANI

**SHQIPTARËT PËRBALLË PROPAGANDAVE TË VENDEVE
FQINJE NË FUND TË SHEK. XIX DHE NË FILLIM TË
SHEK. XX**

Abstrakt

Lindja dhe zhvillimi i lëvizjeve nacionaliste në Evropën e shek. XIX, shpejt u përhap edhe në Gadishullin Ballkanik, ku evoluoi në përgatitjen dhe zhvillimin e revolucioneve kombëtare. Për rrjedhojë, shumica e popujve të kësaj pjese të Evropës Juglindore u çliruan nga sundimi osman dhe krijuan shtetet e tyre kombëtare. Menjëherë pas pavarësimit, shtetet ballkanike i vunë vetes për detyrë t'i zgjeronin kufijtë e tyre me territore të banuara nga popullsi të huaj. Për realizimin e këtij qëllimi, krahas metodave të tjera, ato e përdorën gjerësisht edhe propagandën. Shkolla dhe kisha ishin dy institucionet kryesore të cilat përçonin propagandën e këtyre shteteve në territoret e pretenduara. Secili nga shtetet ballkanike bëri përpjekje për të përvetësuar sa më shumë ortodoksë, përfshirë edhe shqiptarët e këtij besimi. Veprimtaria e qeverive ballkanike në territoret shqiptare u favorizua edhe nga politika e Perandorisë Osmane, e cila as në fillim të shek. XX nuk e njohu konceptin e kombit. Shqiptarët e ndarë në disa besime identifikoheshin sipas përkatësisë fetare. Kjo u mundësoi shteteve fqinje të zhvillonin propagandë të ngjeshur në territoret e banuara nga popullsia shqiptare ortodokse, me qëllimin për t'i përvetësuar ata.

Që nga vitet e fundit të shek. XIX dhe në fillim të atij XX, qeveritë e shteteve ballkanike, zhvilluan rivalitet të ashpër midis tyre për të hapur shkolla dhe për të kontrolluar kishat në territoret që pretendonin t'i aneksonin pas largimit të sundimit osman nga Ballkani. Ato hapën shkolla, të cilat u bënë çerdhe të propagandës, edhe në vendbanimet, në të cilat nuk kishte pjesëtarë të komunitetit të tyre etnik. E gjithë kjo bëhej me qëllim që të ndihmonte në procesin e asimilimit të popullsisë vendëse.

Pavarësisht përkatësisë etnike, gjuhës së folur dhe të kaluarës historike dhe varësisht kishës me të cilët lidheshin banorët e një vendbanimi të caktuar, ata menjëherë identifikoheshin si të tillë (serbë, bullgarë ose grekë). Në shumë raste përdorej dhuna për t'i shkëputur besimtarët nga varësia e njëjës kishë dhe për t'i lidhur me tjetrën, pasi përkatësia kishtare ishte e mjaftueshme për të përcaktuar sipas tyre edhe identitetin etnik. Nën ndikimin e kishës dhe të shkollës, një pjesë e shqiptarëve ortodoksë e humbën identitetin e tyre kombëtar dhe u asimiluan në serbë, grekë ose bullgarë.

Fjalë kyçe: *Propaganda kishtare, shkollat, Serbia, Greqia, Bullgaria, shqiptarët ortodoksë, asimilimi.*

Kishat ortodokse në shërbim të politikës nacionaliste të vendeve ballkanike

Në shek. XIX programi i parë politik ishte shteti kombëtar. Me ndihmën e shkollës dhe të mjeteve të komunikimit masiv zuri vend nacionalizmi i gjuhës dhe i kulturës, që e vlerësonte gjuhën e vet si me vlerë më të lartë nga të tjerat dhe nxiste kësaj etnonacionalizmin kulturor.¹ Gjuhët e pakicave luftoheshin dhe bëheshin përpjekje të vazhdueshme për t'ia imponuar atyre gjuhën e shumicës. Politika nacionaliste e vendeve ballkanike gjatë shek. XIX dhe fillimit të atij XX, u favorizua edhe nga dobësimi i vazhdueshëm i Perandorisë Osmane dhe përkrahja gjithnjë e më e madhe që ato vende patën nga Fuqitë e Mëdha të kohës. Në këto rrethana qeveritë e këtyre vendeve filluan të ndjekin një politik gjithnjë e më nacionaliste, e cila kishte për synim që kur të dëbohej Perandoria Osmane nga Gadishulli Ballkanik, vendin e tij ta zinin këto shtete. Shtetet ballkanike gjatë shek. XIX, i vunë vetes për detyrë që përveç metodave të tjera edhe nëpërmjet propagandës të trazonin terren të përshtatshëm, i cili do t'u krijonte kushte të favorshme që në një të ardhme të afërt të pushtonin territoret osmane në Ballkan. Meqë në shumicën e atyre territoreve jetonte popullsi tjetër, këto shtete vendosën që nëpërmjet shkollës dhe kishës të përvetësonin sa më shumë banorë nga grupet tjera etnike, në territoret e pretenduara.

¹ Urs Altermatt, *Etonacionalizmi në Europë*, Phoenix, Tiranë 2002, 132.

Synimet e politikës së jashtme të vendeve ballkanike u favorizuan edhe nga vetë politika e Portës së Lartë. Deri në fund të ekzistencës së saj, Perandoria Osmane nuk e njohu konceptin e kombit. Ajo i identifikonte shtetasit e saj sipas përkatësisë fetare. Nga të gjitha kombet e perandorisë, shqiptarët u dëmtuan më së shumti nga kjo politikë. Ata u takonin tre besimeve të ndryshme. Sundimi i gjatë osman bëri që krahas dy besimeve të mëparshme ortodokse dhe katolike, një pjesë e madhe e shqiptarëve të konvertoheshin në fenë myslimane.² Kështu, shqiptarët që ishin të ndarë në tri besime*, qeveria osmane, sipas konceptit mesjetar, i ndante në tri milete të ndryshme (osmanlinj, rum dhe katolik-milet) dhe rrjedhimisht jeta e tyre shpirtërore drejtohej nga tri institucione fetare, arsimore dhe kulturore të huaja. Këto institucione fetare vareshin nga tri qendra universale të huaja: Kalifati sulltanor, Patrikana e Stambollit* dhe Papati, asnjëra prej të cilave nuk e përkrahte idenë e një shteti kombëtar shqiptar.³

Dallimet fetare të shqiptarët u mundësuan shteteve fqinje që të zhvillonin propagandën e tyre brenda territoreve shqiptare. Secili prej tyre përpiquej që t'i përfitonte shqiptarët ortodoksë. Për grekët çdonjëri që në aspektin kishtar ishte i lidhur me Patrikanën Ekumenike ishte grek.⁴ Të njëjtën politikë e ndoqën serbët dhe bullgarët në periudhën e mëvonshme.

Të gjithë shqiptarët ortodoksë, pavarësisht nga faktet historike,

² Kristaq Prifti, Diversiteti fetar dhe uniteti kombëtar te shqiptarët. Në *Studime historike*, nr. 1-2. Tiranë 2001, 25-27.

* Krahas këtyre tri grupeve kryesore fetare, një pjesë më e vogël janë bektashinj dhe protestantë.

* Gjatë shek. XIX, një pjesë e ortodoksëve të pjesës ballkanike të Perandorisë Osmane u lidhën me Patrikanën Serbe ose Ekzarkatin Bullgar, varësisht ndikimit që kishte arritur të shtrinte njëra ose tjetra në një territor të caktuar. Për rrjedhojë, besimtarët ortodoksë filluan të identifikoheshin si serbë, grekë ose bullgarë, varësisht se cilës kishë i takonin.

³ Krahaso: *Historia e Popullit Shqiptar II, Rilindja Kombëtare, vitet '30-të të shek. XIX-1912*, Toena, Tiranë 2002, 27; Kristo Frashëri, *Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera*. Tiranë: EDISUD Spa 2006, 129-131; Shih dhe: Maroco dela Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, A. Z. Çajupi, Tiranë 1994, 47- 48; Shukri Rahimi, *Rilindja dhe emancipimi kombëtar*, Fondi republikan për zhvillimin e veprimtarisë botuese, Shkup 1971, 7.

⁴ Charls & Barbara Jelavish, "Themelimi i Shteteve Kombëtare të Ballkanit 1804-1920", *Dituria*, Tiranë 2004, 193.

serbët i identifikonin si serbë të shqiptarizuar.⁵ Për bullgarët të gjithë ata që në aspektin fetar ishin të varur nga Ekzarkati, ishin bullgarë. Politika e identifikimit të përkatësisë fetare me kombin, rriti rivalitetin midis qeverive ballkanike për të dominuar në territore të banuara nga besimtarët ortodoksë. Periudha e fundit e shek. XIX dhe fillimit të atij XX, u karakterizua nga një luftë e ashpër midis kishave ortodokse ballkanike për të përfituar sa më shumë besimtarë, pavarësisht përkatësisë së tyre kombëtare e gjuhësore dhe të kaluarës historike. Ashtu sikurse Porta e Lartë edhe qeveritë dhe kishat ballkanike, për llogari të tyre i quanin serbë, grekë ose bullgarë besimtarët ortodoksë. Për ata nuk kishe rëndësi edhe nëse këta njerëz nuk ishin të tillë për nga origjina. Madje në rastet kur ata vareshin nga një kishë tjetër, ushtrohej dhunë për t'i detyruar të hiqnin dorë nga kisha e mëparshme dhe të lidheshin me kishën e re. Fillimisht për terrorizimin e popullsisë u përdorën bandat, të cilat përkraheshin nga qeveritë përkatëse, kurse nga viti 1912 me këtë çështje u morën ushtritë pushtuese të këtyre vendeve.

Kategorizimi i mësipërm që nuk merrte parasysh gjuhën e folur, të kaluarën historike, prejardhjen etj., por si elementë bazë merrej besimi fetar ishte i dëmshëm për shqiptarët. Kjo për faktin se ata që nga mesjeta u takonin besimeve të ndryshme fetare dhe politika qeveritare për t'i ndarë në tri milete të ndryshme, rrezikonte identitetin kombëtar. Për këtë arsye drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare kërkonin që të gjithë atyre që flisnin gjuhën shqipe, t'u njihej përkatësia etnike shqiptare.

Të vetëdijshëm se shqiptarët e besimeve të ndryshme kishin bashkëjetuar për shekuj me radhë, krahë njëri-tjetrit, kërkesë e veçantë e programit kombëtar ishte edhe njohja e të drejtave të barabarta për shqiptarët e “*të gjitha feve*”. Drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare e kishin të qartë se vetëm të bashkuar mund t'u bënin ballë pretendimeve shkombëtarizuese të shteteve fqinje dhe të vet Perandorisë Osmane. Që gjatë shek. XIX, të shqiptarët filloi të zërë vend gjithnjë e më shumë koncepti gjerman mbi kombin, i cili bazohej mbi themelet gjuhësore. Kështu, feja i hapi rrugë konceptit kombëtar.⁶

Që kur osmanët vendosën pushtetin e tyre mbi Kostandinopojën, në vitin 1453 e deri në shek. XIX, Patrikana e

⁵ Justin McCarthy, *Popujt osmanë dhe fundi i Perandorisë*, Alsar, Tiranë 2017, 69.

⁶ Nicola Guy, *Lindja e Shqipërisë*, Pegi, Tiranë 2012, 16-17.

Stambollit kishte pozitë të privilegjuar* ndër popullsinë ortodokse të perandorisë. Ajo ishte institucion sa fetar aq edhe arsimor dhe kulturor. Si e tillë mbështeti idetë nacionaliste greke dhe i luftoi ato të popujve të tjerë.⁷ Kështu, fillimisht rreziku kryesor për shkombëtarizimin e shqiptarëve ortodoksë vinte nga Patrikana e Stambollit, prandaj një pikë e veçantë e programit kombëtar ishte edhe njohja e autonomisë për Kishën Ortodokse Shqiptare. Patrikana e drejtuar nga grekët në vazhdimësi i kishte shërbyer politikës së qeverisë së Athinës. Nëpërmjet priftërinjve dhe mësuesve të emëruar prej saj, zhvillohej një politikë asimiluese ndër shqiptarët ortodoksë, e cila në disa raste dhe kishte pas sukses. Për pengimin e kësaj fushate ishte e domosdoshme që komuniteti ortodoks shqiptar të shkëputej nga varësia greke.

Për realizimin e synimeve të tyre ekspansioniste shtetet ballkanike përdorën çdo mjet të mundshëm, duke përfshirë edhe dhunën. Dhuna ndaj “*të huajve*” në Ballkan mori përhapje të gjerë në fund të shek. XIX. Ajo do të jetë e pranishme edhe në periudhën në vazhdim dhe do të shfaqet në periudha të ndryshme gjatë shek. XX. Sa herë do t’u jepet rasti, shtetet ballkanike do ta shfrytëzojnë në maksimum mundësinë për të pushtuar territore të huaja, duke përdorur çdo mjet, madje edhe ato të zhdukjes masive të popullsive tjera.

Propaganda serbe

Që me formimin e saj Principata Serbe politikën e jashtme e orientoi drejt “*territoreve osmane*”. Klasa politike serbe i vuri vetes si detyrë parësore të krijonte terren të përshtatshëm në territoret që ende ishin pjesë e Perandorisë Osmane, e cila kur të largohej nga Evropa Juglindore, një pjesë të tyre t’i merrte Serbia. Në funksion të kësaj politike ishte edhe “*Naçertania*”, e hartuar në vitin 1844, e cila

* Sipas marrëveshjes së arritur në vitin 1454, midis sulltan Mehmet Fatihut dhe patrikut të Kostandinopojës, të gjithë ortodoksët e Perandorisë Osmane konsideroheshin rum mileti, që nënkuptohej se ishin bizantinë ose grekë dhe mbi ta Patrikana ushtronte autoritet të pakufizuar fetar. Katolikët trajtoheshin si pjesëtarë të latin milet, në kuptimin e besimtarëve të varur fetarisht nga Roma. (Shih më gjerësisht: Kristo Frashëri, *Identiteti kombëtar shqiptar dhe çështje të tjera*, EDISUS Spa, Tiranë, 2006, 131.

⁷ Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Dituria, Tiranë, 2002, 262.

parashikonte që në të ardhmen pjesë e shtetit serb të bëheshin Kosova, Shqipëria Veriore, Maqedonia etj.⁸

Ideja e Garashaninit për krijimin e një shteti të madh serb, do të gjej mbështetje edhe te intelektualë serbë, në periudhën që pasoi. Serbët e shihnin veten sikur të ishin *Piemonti ballkanik*, me detyrën jo për t'i çliruar sllavët e jugut nga robëria⁹, por për t'i vendosur nën kontrollin e tyre. Ata e konsideronin Serbinë e atëhershme si bërthamën rreth së cilës do të bashkoheshin të gjithë sllavët e jugut. Madje, përpos territoreve sllave që ishin pjesë e Perandorisë Osmane dhe asaj Habsburge ata synonin edhe pushtimin e territoreve shqiptare.

Në periudhën e fundit të shek. XIX dhe fillimin e atij XX, Porta e Lartë vazhdoi që herë të aprovonte kërkesat e njëjës e herë palës tjetër, duke bërë lëshime të vazhdueshme. Për të penguar fuqizimin e ndikimit bullgar në Ballkan, qeveria osmane favorizonte kërkesat serbe, me qëllim që këto dy propaganda të viheshin përballë njëra-tjetrës. Kjo politikë lëshimesh dëmtoi interesat e shqiptarëve, por dhe të vet Perandorisë Osmane. Ambasadori serb në Stamboll, Vlladan Gjorgjeviq, arriti të siguronte leje të reja nga qeveria osmane për hapjen e shkollave serbe në vilajetin e Kosovës dhe atë të Manastirit.¹⁰ Në kuadër të kësaj politike, pas vizitës së ministrit të Punëve të Jashtme të Malit të Zi, vojvodës Gavro Vukotiq, në Stamboll, në shtator 1903, sulltani dekretoi fermanin për njohjen e kombësisë serbe në Maqedoni.¹¹ Në atë periudhë të malazezët ende nuk ishte zhvilluar ndërgjegjja kombëtare, prandaj ata vazhdonin ta konsideronin veten serbë dhe për rrjedhojë ëndërronin që në të ardhmen të bëheshin qendra e botës serbe. Në këtë kuadër ata e ndihmonin çështjen serbe. Vendet ballkanike kishin shpenzuar shuma të mëdha për propagandë në tokat që ishin pjesë e shtetit osman dhe e dinin se po të viheshin në zbatim kërkesat e tyre, të përsëritura Perandorisë Osmane, për reforma, të gjitha planet e tyre për zgjerime tokësore do të prisheshin. Prandaj, ata filluan të formonin çeta dhe të dendësonin propagandën.

⁸ Gazmend Rizaj, *Shqipëria e Sipërme 1800 - 1913*, Instituti Albanologjik, Prishtinë 2011, 102.

⁹ Mark Mazower, *Ballkani-një histori e shkurtër*, Botimi i dytë, Skanderbeg Books, Tiranë 2010, 110.

¹⁰ Sadik Mehmeti, *Shkollat dhe arsimit në Kosovë 1830-1912*, Instituti Albanologjik, Prishtinë 2019, 370, 371, 374.

¹¹ Antonio Baldacci, *Shqipëria e Madhe*, Uegen, Tiranë 2006, 53.

Serbët formuan shoqërinë *Narodna Odbrana* dhe hapën shkolla, në të cilat oficerët stërvitnin çetat e komitëve vullnetarë se si të hidhnin bomba, të prishnin trena, të minonin dhe të gjuanin me armë. Serbia, me një propagandë fare të re në Maqedoni, kërkonte të fitonte kohën e humbur duke themeluar shkolla dhe duke dërguar komitë¹², pasi bullgarët kishin avancuar dukshëm me propagandën e tyre.

Synimi i gjithë kësaj ndërmarrjeje serbe në hapësirën shqiptare ishte që përpara opinionit të jashtëm t'i paraqiste ato territore si toka të banuara nga popullsia serbe dhe gjithashtu kishte për qëllim serbizimin e popullsisë autoktone vendase. Përpjekjet për asimilimin e shqiptarëve në serbë kishin filluar që në mesjetë, por ky proces vazhdoi edhe në periudhën e mëvonshme, madje edhe gjatë shek. XX¹³, kur një pjesë e shqiptarëve ortodoksë në mungesë të kishës së tyre kombëtare ishin përthithur si nga serbët në territoret shqiptare lindore dhe veriore, ashtu edhe nga grekët në viset jugore. Deri në fillim të shek. XIX, fshatrat e rrethinës së Vushtrrisë: Sllatinë dhe Rasnik ishin krejtësisht shqiptare, por që atëherë u kthyen plotësisht në serbe.¹⁴

Në shërbim të politikës së qeverisë së Beogradit u vu edhe Kisha Ortodokse Serbe (KOS). Për dallim nga patriku i Stambollit, i cili pretendonte për një sundim fetar universal, në të cilin do të mbizotëronte gjuha greke, (por që realisht ishte në shërbim të politikës greke), kishat tjera ishin kombëtare dhe si të tilla ato e vinin theksin në shkollat kombëtare, krenarinë kombëtare dhe shenjtorët kombëtarë. Ato u shërbyen kauzave kombëtare dhe të politikave asimiluese dhe pushtuese që zhvillonin shtetet e tyre. Ashtu sikurse qeveria serbe edhe kisha të gjithë shqipfolësit ortodoksë, pavarësisht fakteve historike, i identifikonin si “*serbë shqipfolës*”.¹⁵ Pra, sipas tyre këta shqiptarë dikur kishin qenë serbë, por që më vonë ishin asimiluar. Një pohim që ishte tërësisht në kundërshtim me faktet historike. Për qeverinë dhe kishën serbe ishte e pakuptueshme se një popull siç ishin shqiptarët mund t'u takonin disa besimeve fetare. Një shtet i cili është

¹² Edith Durham, *20 vjet ngatërresa ballkanike*, Argeta - LMG, Tiranë 2001, 216.

¹³ Shih: Noel Malcolm, *Kosova-një histori e shkurtër*, Koha-Shtëpia e Librit, Prishtinë-Tiranë 2001, 205.

¹⁴ Mid'hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, 2, Instituti i Studimeve Historike: Lumo Skëndo, Tiranë 2018, 225. Shih referencën 199, 224-225.

¹⁵ Shih: Justin McCarthy, *Popujt osmanë...*, 62, 69.

karakterizuar nga mungesa e tolerancës fetare, e kishte të vështirë ta kuptonte bashkëjetesën fetare të shqiptarëve. Identifikimi i ortodoksëve shqiptarë si serbë ishte gjithashtu edhe në interes të politikës së tyre ekspansioniste ndaj territoreve shqiptare veriore dhe lindore. Ata përpiqeshin që maksimalisht ta rrisnin artificialisht numrin e serbëve që jetonin në territoret osmane, për të pasur argument më të fuqishëm që në të ardhmen ta dërgonin ushtrinë e tyre për t'i "çliruar" ato territore nga sundimi osman.

Popullsia ortodokse shqiptare, si në statistikat zyrtare të shtetit osman, ashtu edhe në ato të vendeve fqinje evidentohesh si serbe, greke ose bullgare, varësisht rajonit ku ishte e përqendruar kjo popullsi dhe kishës të cilës i takonte. Kur shqiptarët ortodoksë ishin të varur nga Patrikana e Stambollit, automatikisht trajtoheshin si grek. Nëse ishin të lidhur me Ekzarkatin bullgar atëherë konsideroheshin bullgarë dhe nëse vareshin nga kisha serbe evidentoheshin si serbë. Duke mos pasur kishën e tyre të pavarur, shqiptarët ishin të detyruar të lidheshin me ndonjërin nga kishat ekzistuese.

Por, varësia kishtare dhe përkatësia fetare nuk ishin tregues të identitetit të tyre etnik. Gjuha e folur e kësaj popullsie, që duhej të ishte bazë për përcaktimin etnik të saj, asnjëherë nuk merrej parasysh nga këto vende kur publikonin statistika për popullsinë e një rajoni të caktuar. "*Sllavët kanë qenë të prirë që t'i shohin shqiptarët ortodoksë, në Ohër, në Manastir, në Prishtinë apo Pejë si sllavë*". Në shumë vendbanime shqiptare, popullsia ortodokse gjuhë amtare e kishte shqipen. Në Tetovë "*...një pjesë e banorëve ortodoksë... në vatrat e tyre kanë në përdorim vetëm gjuhën shqipe*". Por, këta banorë për serbët ishin pjesë e kombit të tyre. Të dhëna me mjaft interes për praninë e elementit ortodoksë shqiptarë në vilajetin e Kosovës sjell Mit'hat Frashëri. Sipas tij, në Vushtrri dhe në Pejë gati të gjithë ortodoksët ishin shqiptarë, pavarësisht se i regjistronin si sllavë. Ata dalloheshin nga serbët dhe bullgarët nga disa veçori, si: zakonet e përditshme, të folurit shqip nga gratë dhe fëmijët e tyre në vatrat familjare etj. Mirëpo, nën ndikimin "*e kishës, klerit dhe të shkollës, të krishterët e Tetovës dhe të Pejës janë konsideruar shpesh sllav*". Në statistikat e tyre, serbët dhe bullgarët si shqiptarë i evidentonin vetëm ata shqiptarë që praktikonin fenë myslimane ose katolike, kurse ortodoksët i cilësonin si serbë ose bullgarë¹⁶, varësisht se kush i

¹⁶ Mid'hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, 2..., 190, 195-196, 204, 226.

publikonte statistikat. Institucionet e kishës dhe të shkollës kishin ushtruar ndikimin e tyre mbi burrat ortodoksë shqiptarë të cilët krahas shqipes i përdornin edhe gjuhët sllave, megjithëse në shtëpitë e tyre flitej gjuha shqipe.

Se varësia kishtare ishte përcaktuese për identitetin kombëtar, sipas zyrtarëve të vendeve ballkanike, e dëshmon edhe rasti me banorët ortodoksë të krahinës së Ohrit. Shqiptarët ortodoksë të pjesës veriore të këtij rajoni ishin të lidhur me kishën bullgare, prandaj padrejtësisht evidentohen si sllavë. Në të njëjtën periudhë, bashkëkombësit e tyre që jetonin më në jug të Ohrit ishin nën varësinë e kishës greke dhe ky ishte “*argument*” i mjaftueshëm që ata të konsideroheshin grekë, pavarësisht faktit se nganjëherë vetë grekët i quanin ata *alvanophono*i (d.m.th grekë që flisnin gjuhën shqipe).¹⁷ Është e pranuar gjerësisht se krahas disa elementeve, si: e kaluara historike e përbashkët, traditat, doket, zakonet, posedimi i një territori kompakt etj., elementi bazë në përcaktimin e identitetit kombëtar të një grupi etnik është gjuha e folur, ajo të cilën pjesëtarët e grupit e kanë të trashëguar nga brezat e mëparshëm dhe që quhet gjuha amtare. Në rastin e shqiptarëve ortodoksë, pothuajse asnjëherë as vendet fqinje dhe as Perandoria Osmane nuk i merrnin për bazë asnjërin nga këto elemente dhe as gjuhën e folur, por për ta përcaktues ishte përkatësia kishtare e pjesëtarëve të komunitetit ortodoksë.

Identitetin etnik të popullsisë shqiptare ortodokse e ndryshonin në varësi të asaj se kush drejtonte me kishën lokale. Në fshatin Niçpur të rajonit të Rekës (midis Gostivarit dhe Dibërës), deri në vitin 1903, popullsia ortodokse ishte e lidhur me kishën bullgare, kurse pas atij viti u lidh me Patrikanën e Pejës. Fillimisht ata njiheshin si bullgarë, por më vonë do të njihen si serbë.¹⁸ Presioni serb për asimilimin e shqiptarëve ortodoksë, çoi në vitin 1904, në shpërthimin e një kryengritje kundër Kishës Serbe në Manastir nga shqiptarët.¹⁹ Një pjesë e popullsisë shqiptare nën ndikimin e kishës dhe të shkollës e humbi edhe gjuhën dhe për rrjedhojë edhe identitetin kombëtar. Popullsia e Zhironicës në rajonin e Rekës, e cila ishte edhe qendër e nahijes me të njëjtin emër u takonte dy besimeve fetare, ortodokse dhe

¹⁷ Po aty, 195.

¹⁸ Дода Бајазид & Барон Нопча, Франц, *Селскиот живот во Горна Река кај Дебар*, Тринга Дизајн, с. Тетово 2001, 16.

¹⁹ Nuray Bozbor, *Shqipëria dhe nacionalizmi...*, 225.

muslimane. Pas një kohe të krishterët filluan të flasin sllavisht, kurse myslimanët e ruajtën gjuhën shqipe. Ndonëse edhe të krishterët e kuptonin gjuhën shqipe dalëngadalë u sllavizuan. Bashkëkohës të ndryshëm dëshmojnë se edhe në fillim të shek. XX “*të gjithë (ortodoksë dhe myslimanë -F.R.) e kuptojnë gjuhën shqipe*”. Por, në periudhën e mëvonshme si pasojë e presionit shtetëror e humbën kombësinë dhe u asimiluan.²⁰ Propaganda e Serbisë nëpërmjet kishës dhe shkollës arriti të asimilonte pjesën më të madhe të popullsisë shqiptare ortodokse. Pas pushtimit serb të territoreve shqiptare lindore dhe verilindore (në vitet 1912-1913), ky proces u përshpejtua. Autoritetet shtetërore herë duke përdorur presionin e herë duke ofruar privilegje, çuan gati në asimilimin e plotë të këtij komuniteti. Shteti nxiste edhe martesat e përziera, të cilat e ndihmonin këtë proces. Gjuha sllave u bë gjuhë e shtëpisë edhe në ato familje që deri në atë kohë i kishin rezistuar asimilimit.

Hapja e shkollave fetare pengonte zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare te fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë, pasi shkollat osmane dhe të tjera të huaja u shërbenin propagandave të shteteve, nga të cilët financoheshin. Si shkollat myslimane ashtu edhe ato që financoheshin nga shtetet fqinje kishin për qëllim asimilimin e shqiptarëve. Porta e Lartë nëpërmjet shkollave fetare dhe arsimimit në gjuhën osmane synonte që shqiptarët myslimanë t’i shndërronte në osmalinj. Qëllime të njëjta kishin edhe shtetet fqinje si Greqia, Serbia dhe Bullgaria nëpërmjet shkollës dhe kishës synonin asimilimin e shqiptarëve ortodoksë. Një pjesë e mirë e këtyre të fundit, si pasojë e shkollës dhe kishës, e kishin humbur identitetin e tyre kombëtar dhe të njëjtin rrezikonin ta humbnin edhe pjesa tjetër. Shqiptarët e krishterë të Rekës refuzuan të mësonin serbisht, greqisht apo bullgarisht. Ata kërkonin të mësonin në gjuhën shqipe.²¹ Të revoltuar nga kjo politikë mohimit të arsimit dhe e ushtrimit të praktikave fetare në gjuhën amtare, më 27 janar 1912, banorët e nëntë fshatrave të krahinës së Rekës (krahinë midis Gostivarit dhe Dibrës), i dërgonin një letër sulltanin, nëpërmjet të cilës kërkonin nga ai që t’u mundësonte zhvillimin e meshës në gjuhën shqipe dhe angazhimin e mësuesve shqiptarë në shkollat e tyre. “Shqiptarët ortodoksë të Rekës [...]” i

²⁰ Дода Бајазид & Барон Нопча, Франц, *Селскиот живот...*, 18.

²¹ Villado Popovski, *Lëvizja Kombëtare Çlirimtare Shqiptare (19830-1912)*, Arbëria Design, Tetovë 2012, 188-189.

njoftonin autoritetet osmane se “këtej e tutje nuk do ta njohin klerin grekë si kryesi të kishës”. Ata kishin njoftuar qeverinë osmane se nuk do të pranonin as priftërinj dhe as mësues të huaj, sepse “ne nuk jemi as grekë, as serbë e as bullgarë”. Nëse kërkesa e tyre nuk do të realizohej, ata kërcënonin se do të detyroheshin të kërkonin mbrojtjen e Selisë së Shenjtë.²² Ata shpresonin se duke kaluar nën mbrojtjen e Vatikanit, meshën dhe shkollën do të kishin mundësi t’i zhvillonin në gjuhën shqipe, ashtu siç ndodhte në shkollat katolike që ishin nën mbrojtjen e Austro-Hungarisë.

Më 1910, në Shkup themelohet “*Organizata e Serbëve Osmanë*”, nën drejtimin e Radenkoviq. Kjo organizatë që u themelua me pëlqimin e xhonturqve, formoi degët e saj nëpër gjithë Kosovën dhe Maqedoninë dhe nga 14 shtatori i atij viti nisi të botonte organin e saj të shtypit “*Vardar*”, nëpërmjet të cilit përhapte propagandën serbe në ato territore. Kjo organizatë zhvilloi veprimtari të dendur kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ajo luftonte kundër të gjitha përpjekjeve të shqiptarëve për arsim dhe emancipim. Në vitin 1910 ajo iu bashkua fushatës xhonturke kundër përdorimit të alfabetit latin nga shqiptarët.²³

Në vitin 1912, Serbia e rriti veprimtarinë e bandave çetnike në kufi me Kosovën. Në shtator filloi një propagandë e vrullshme, duke u dorëzuar konsujve perëndimorë lista mbi “*barbarizmat*” e shqiptarëve. Nënkonsulli britanik në Shkup bëri verifikimin e 12 rasteve të “*barbarizmave*”, sipas një liste serbe dhe arriti në përfundimin se “*disa nga rastet e paraqitura në listë ishin të pavërteta, ndërsa në rastet tjera: përgjegjësinë e kishin vet serbët*”.²⁴ Për realizimin e synimeve të tyre qeveria serbe ka përdorur të gjitha mjetet, si propagandën, dhunën, terrorin, falsifikimet, mashtrimet. Përpara përfaqësuesve të shteteve të huaja ata gjithmonë e paraqisnin veten e tyre viktimë e të tjerëve edhe në rastet kur sulmi ishte iniciuar dhe kryer nga autorë serbë. Duke u ankuar në sytë e diplomatëve të huaj shpresonin të siguronin përfitime për vete, që shpeshherë edhe kanë pasur sukses.

²² Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë. Më tej: AIH, Vj. 22- 20- 2039. Relacion i shqiptarëve ortodoksë të Rekës drejtuar autoriteteve osmane. Zharmonicë (Rekë), më 27 janar 1912.

²³ Sadik Mehmeti, *Shkollat dhe arsimi...*, 370-371.

²⁴ Noel Malcolm, *Kosova-një histori...*, 261.

Diplomati dhe poeti serb, Milan Rakiq, një zyrtar i ulët konsullorë në letrat e tij vinte në dukje se serbët qëllimisht i zmadhonin vuajtjet e tyre në Kosovë “*me qëllim që të siguronin ose ndonjëfarë ndihme ose para ose ndonjë pushkë ose ndonjë revole*”, kurse numri për vrasjen e serbëve ekzagjerohej vazhdimisht. Ai pohonte se Serbia financonte *çetat* serbe, të cilat i inkurajonte jo vetëm të luftonin në Kosovë, por edhe t’u kundërviheshin çetave maqedonase apo bullgare në Maqedoni dhe për të krijuar lëvizje proserbe atje. Në Kosovë këto çeta përlesheshin me shqiptarët vendas²⁵ dhe në takimet që diplomatët serbë zhvillonin me përfaqësuesit e huaj diplomatik ankoheshin se shqiptarët i sulmonin serbët pavarësisht se e vërteta ishte krejtësisht ndryshe.

Serbët për të imponuar ndërgjegjen kombëtare, patën në shërbim të tyre kishat, shkollat, bandat e armatosura si dhe mbështetjen e Fuqive të Mëdha, të afta për t’ia imponuar vullnetin e tyre Perandorisë Osmane.²⁶ Me këtë politikë, Serbia krijoi terren të përshtatshëm për të vazhduar në vitet 1912-1913 gjenocidin e nisur mbi shqiptarët në vitet 1877-1878.

Propaganda greke

Që nga pavarësimi i saj, në vitin 1830, Mbretëria e Greqisë politikën e saj të jashtme e orientoi drejt pushtimit të vendeve të tjera. Ashtu sikurse revolucionarët grekë edhe qarqet politike të Athinës i konsideronin grekë të gjithë ortodoksët e Perandorisë Osmane, pavarësisht origjinës së tyre etnike. Në mesin e viteve ’40-të të shek. XIX, Greqia dhe Serbia hartuan projektet e tyre shtetërore, të cilat u vunë në themel të politikës së tyre të jashtme. Në janar të vitit 1844, kryeministri grek, me prejardhje vllahe, Janis Koletis shpалosi para Asamblesë Kushtetuese në Athinë programin e njohur si “*Ideja e Madhe*” (Megali Idhea), i cili synonte shndërrimin e Mbretërisë së vogël Greke në një shtet të madh²⁷, brenda kufijve të së cilës do të përfshiheshin edhe shumë territore shqiptare. Përkrahëse e flaktë e këtij programi ekspansionist të qeverisë së Athinës u bë Patrikana e

²⁵ Po aty, 244-245.

²⁶ Mid’hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, 2..., 206.

²⁷ Misha Glenny, *Histori e Ballkanit 1804-1999 - nacionalizmi, luftërat dhe Fuqitë e Mëdha*, Toena, Tiranë 2007, 45.

Stambollit, e cila zhvilloi politikë helenizuese nëpërmjet kishës dhe shkollës.

Patrikana e Stambollit, e cila gëzonte pozitë të privilegjuar ndër besimtarët ortodoksë të pjesës evropiane të Perandorisë Osmane, zhvilloi propagandë të ngjeshur në favor të çështjes greke. Meqenëse gjuhë zyrtare e saj ishte greqishtja, në të gjitha kishat dhe shkollat që mbulonte ajo në territoret ballkanike, gjuhë predikimi dhe mësimi ishte gjuha greke. Në krye të saj qëndronte patriku, i cili gjithashtu në vazhdimësi ishte dikush që kishte origjinë greke. Në këto kushte, kjo qendër fetare filloi të perceptohet nga grekët më tepër si institucion i tyre kombëtar sesa institucion fetar, i cili realisht duhej t'u shërbente vetëm çështjeve religjioze. Gjatë periudhës së shek. XIX, kur idetë kombëtare u përhapën edhe ndër popujt e Ballkanit, Patrikana u vu në shërbim të plotë të kauzës greke. Që nga ajo kohë, veprimtaria e saj në territoret shqiptare më tepër kishte karakter politik sesa fetar. Ajo nëpërmjet priftërinjve dhe mësuesve u angazhua për greqizimin e pjesëtarëve të komunitetit ortodoksë shqiptarë.

Shkollat greke luajtën rol pengues në zhvillimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Mësuesit grekë u thoshin fëmijëve se ishte e kot t'i luteshin Zotit në gjuhën shqipe. Priftërinjtë grekë, në predikimet e tyre pohonin se Jezus Krishti kishte folur greqisht dhe jo shqip dhe pikërisht, për këtë arsye, nëse ata dëshironin të ishin të krishterë të mirë, duhej të hiqnin dorë nga lëvrimi i shqipes dhe të mësonin greqisht.²⁸ Në të gjitha territoret shqiptare jugore Patrikana e Stambollit kishte hapur shkolla në të cilat jepnin mësim mësues grekë. Në Korçë dhe në Janinë funksiononin edhe gjimnaze greke, "*kurse propaganda greke punonte në vazhdimësi në dëm të çështjes shqiptare*". Ashtu sikurse sllavët edhe grekët kishin sisteme arsimore të mirorganizuara dhe "*...duhet të ketë qenë ndonjë mrekulli, - shkruan Joseph Swire, - që grekët nuk arritën të helenizojnë një numër të konsiderueshëm shqiptarësh*".²⁹ Me plotë të drejtë njëri ndër intelektualët shqiptarë të kohës, Faik Konica, i shihte grekët si pengesë kryesore në rrugën drejt formimit të shtetit shqiptar.³⁰

²⁸ AIH, Vj. 18-4-500. Memorandum i shqiptarëve drejtuar botës së qytetëruar, në vitin 1908. (Nuk dihet kush ishin hartuesit e tij).

²⁹ Joseph Swire, *Shqipëria- ngritja e një mbretërie*, Dituria, Tiranë 2005, 69.

³⁰ Daut Dauti, *Britania dhe çështja shqiptare-gjatë rënies së Perandorisë Otomane 1876-1914*, Shkup: Logos-A, 2020, 134.

Në çerekun e fundit të shek. XIX, lufta për dominim në territoret osmane në Evropë nga shtetet ballkanike u bë e ashpër. Deri në vitet '70-të të atij shekulli, Patrikana kishte dorë të lirë në çështjet fetare, në të gjitha territoret evropiane të shtetit osman*. Por, atë kohë sulltani njohu pavarësinë e kishës bullgare, të cilës i njohu të drejta të barabarta me Patrikanën. Tanimë edhe Ekzarkati kishte të drejtën e emërimit të priftërinjve dhe të mësuesve në territoret ku jetonin “*besimtarët e tij*”. Ashtu sikurse Patrikana edhe kisha bullgare e shfrytëzoi këtë të drejtë për të shtrirë sa më shumë ndikimin e saj. Prandaj edhe bullgarët i quanin të tyre rajonet në të cilat jetonin ortodoksë, pavarësisht se shpeshherë ata nuk ishin bullgarë. Kjo bëri që këto dy kisha të zhvillonin një rivalitet të ashpër midis tyre.

Dështimi i përpjekjeve të Patrikanës greke të Stambollit për ta penguar krijimin e Ekzarkatit, solli vendimin e saj për t'i shpallur skizmatikë dhe të mallkonte klerin ekzarkistë dhe gjithë pasuesit e tyre. Masat e marra nga Patrikana kishin karakterin e inkuizicionit mesjetar. Në këtë drejtim një masë e fajit i takonte edhe vetë sulltanit, pasi me dekret të posaçëm i kishte njohur patriarkut të drejtën e mallkimit.³¹

Premtimi i sulltanit, pas themelimit të Ekzarkatit bullgar, se krahas dioqezave ekzistuese do të themelonte edhe të reja, nëse një gjë e tillë do të kërkohej nga popullsia vendase, bëri që klerikët e të dyja palëve të zhvillonin propagandë të ethshme, që shpesh përfundonte në konflikte të armatosura. Popullsia shtrëngohej të kërkonte herë themelimin e dioqezës bullgare e herë në rastet kur kishte pranuar ekzarkatin, detyrohej nga grekët të rikthehej përsëri në gjirin e Patrikanës. Këto mosmarrëveshje bullgaro-greke i shfrytëzonte sulltani për të mos zbatuar reformat me arsyetimin se këto antagonizma ia pamundësonin një gjë të tillë. Në këtë mënyrë kreu i Perandoria Osmane e forconte pushtetin e tij në Ballkan dhe

* Kisha e pavarur Greke ishte themeluar që në vitin 1833 dhe ajo përfaqësohte vetëm popullsinë greke të Greqisë së Vjetër, të atij shteti grek të krijuar në vitin 1830. Pjesa tjetër e popullsisë greke, që deri në luftërat ballkanike (1912-1913), jetonte në shtetin osman, përfaqësohej nga Patriarkana e Stambollit.

³¹ *AIH*, A-IV-154, Timo Dilo, *Shqipëria në vitet e fundit të shek. XIX*, Kap. XVI-1229-C, 13.

njëkohësisht pengonte arritjen e një aleance midis këtyre dy popujve kundër perandorisë së tij.³²

Çdo dioqezë gëzonte të drejtën e hapjes së shkollës për besimtarët e saj respektivë. Shpesh kjo e drejtë shfrytëzohej nga klerikët për të hapur shkolla edhe atje ku nuk kishte besimtarë.³³ “*Grekëve iu pëlqen të ngatërrojnë kishën me kombësinë... pra kur një grek përdor këtë fjalë (kombësinë), ai më shpesh nënkupton ritin ortodoks, kishën greke*”.³⁴ Patriku grek kërcënonte me shkishërim çdo shqiptar që përdorte “*gjuhën e mallkuar*” qoftë në kishë apo në shkollë. Mësuesit bënin gjithçka që ishte e mundur të rrënjosnin te fëmijët ndjenjë të rreme kombëtare.³⁵ Shkolla dhe kisha greke ndikuan që një pjesë e shqiptarëve ortodoksë, të territoreve shqiptare jugore të asimiloheshin. Institucionet fetare dhe arsimore bënë që një pjesë e shqiptarëve ta harronin gjuhën e tyre amtare dhe të greqizoheshin.³⁶

Ortodoksët shqiptarë duke mos pasur Kishën e tyre Autoqefale ishin të varur nga Patrikana. Kjo varësi bëri që shumë prej tyre nën presionin e kishës të deklaroheshin grekë. Kush kundërshtonte politikën asimiluese të Patrikanës mallkohej dhe shpallej heretik. Për rrjedhojë, prifti refuzonte të pagëzonte fëmijën e familjes së mallkuar, nuk kurorëzonte çiftet e reja në martesë, madje atyre u refuzohej edhe një copë tokë në varreza.³⁷ Ky presion i vazhdueshëm bëri që një pjesë e ortodoksëve shqiptarë të nënshtroheshin. Sipas disa të dhënave, vetëm në sanxhakun e Janinës rreth 20 000 shqiptarë ishin greqizuar.³⁸

Për greqizmin e krahinave të gjera të Shqipërisë së Jugut, një pjesë e përgjegjësishë i takonte qeverisë osmane, e cila ishte pengesa kryesore e hapjes së shkollave dhe zhvillimit të mësimin në gjuhën shqipe. Gjuhë e mësimdhënies për të krishterët mbeti greqishtja, kurse

³² AIH, A-IV-154, Timo Dilo, *Shqipëria në vitet e fundit të shek. XIX*, Kap. XVI-1229-C, 14.

³³ AIH, A-IV-154, Timo Dilo, *Shqipëria në vitet e fundit të shek. XIX*, Kap. XVI-1229-C, 15. (referenca 1).

³⁴ Mid'hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, 2..., 105.

³⁵ Po aty, 107.

³⁶ Shih: Sami Frashëri, *Personalitetet shqiptare në Kâmûs al-A'lâm*, Logos-A, Shkup 44.

³⁷ Mid'hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, 2..., 107, 108.

³⁸ Peter Bartl, *Muslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare (1878-1912)*, Dituria, Tiranë, 2006, 99.

për myslimanët osmanishtja. Edukimi i fëmijëve të krishterë në gjuhën greke luajti rol të rëndësishëm në asimilimin e popullsisë së trevave jugore shqiptare. Eqrem Vlora, në veprën “*Nga Berati dhe nga Tomori*”, - do të shkruante “... për pjesën e kamur të popullsisë së krishterë të Beratit dhe Vlorës gjuha greke është gjuha e folur në shtëpi, ndërsa jo më shumë se 20 vjet më parë, nuk kuptohej nga njeri, në jug është arritur helenizimi i krahinave të tëra”. Gjithashtu, popullsia e krahinës së Himarës dhe të Sulit, “100 vjet më parë ishin shqiptare të pastra, sot vetëm në pak shtëpi e dëgjon gjuhën e të parëve”.³⁹ Antonio Baldacci, në vitin 1903, shkruante se suljotët ndonëse flisnin greqisht, ata ishin të vetëdijshëm për origjinën e tyre shqiptare. Sa më thellë të shkoje në jug aq më shumë vërehej presioni grek mbi popullsinë shqiptare. Sa më afër Greqisë aq më i madh ishte asimilimi shqiptarëve. “*Popullsia shqiptare mbajti shumë gjatë kohë dygjuhësinë dhe kështu është edhe sot në shumë krahina larg nga qendra*”.⁴⁰ Deri vonë femrat në Himarë flisnin vetëm gjuhën shqipe, kurse burrat komunikonin edhe greqisht, italisht⁴¹ e ndonjë gjuhë tjetër për shkak të kontakteve që kishin me të huajt. Por, ndikimi i kishës dhe shkollës kishte bërë që dalëngadalë greqishtja të zinte vendin e shqipes në familjet shqiptare dhe kështu popullsia humbi identitetin shqiptar.

Në lidhje me politikën asimiluese të kishës greke në territoret shqiptare jugore, njëri ndër intelektualët më të shquar shqiptar të gjysmës së parë të shek. XX, Mid’hat Frashëri, sjell një ndodhi të cilët e kishte përjetuar vetë ai. Kur kishte vizituar disa fshatra të krahinës së Sulit, ai kishte takuar një djalë 10-vjeçar, të cilit i ishte drejtuar në gjuhën shqipe. Por, djali i përgjigjet se nuk e kuptonte këtë gjuhë. Mirëpo, pasi ky insiston disa herë djali pranon se mësuesi i shkollës ua kishte ndaluar të flisnin gjuhën amtare dhe se kushdo që do e shkelte këtë vendim të tijin do të shpallej heretik dhe do të shkishërohej. Madje do të dënoheshin edhe me rrahje me kamxhik.⁴² Për të shpëtuar nga ndëshkimi, fëmijët refuzonin të flisnin në gjuhën e nënës.

³⁹ Peter Bartl, *Myslimanët shqiptarë...*, 116.

⁴⁰ Antonio Baldacci, *Shqipëria e Madhe*, Uegen, Tiranë 2006, 75.

⁴¹ Mid’hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, 2..., 112.

⁴² Po aty, 114.

Politika e vendeve fqinje për asimilimin kombëtar të shqiptarëve ortodoksë ndikoi që një pjesë e tyre të kërkonin alternativa të tjera, të cilat do t'u mundësonin atyre që ta ruanin besimin fetar pa e humbur identitetin kombëtar. Është e njohur përpjekja e ortodoksëve të Shpatit (krahinë e Elbasanit), të cilët kërkonin mbështetjen e Vatikanit për themelimin e kishës uniate. Konsulli austro-hungarez në Shkodër, T. Ippen, u përfshi në këtë proces duke u përpjekur t'i ndihmonte në këtë drejtim. Sipas tij arsyeja e vërtetë pse ortodoksët kërkonin të lidheshin me kishën katolike, nuk ishte dashuria e tyre për Austro-Hungarinë, por neveria që kishin të krishterët ortodoksë shqiptarë për tendencat helenizuese të Patrikanës Ekumenike.⁴³ Nëpërmjet këtij veprimi ata shpresonin që të ruanin edhe besimin e mëparshëm fetar (duke njohur papën si kreun e tyre fetar, por duke praktikuar normat ortodokse) edhe identitetin e tyre kombëtar. Në dallim nga kishat ortodokse, të cilat kishin karakter kombëtar dhe për rrjedhojë u shërbenin kauzave kombëtare, Vatikani kishte karakter universal. Selia e Shenjtë nuk bënte presion mbi besimtarët e saj që ta ndryshonin identitetin kombëtar, ashtu siç ndodhte me kishat ballkanike. Megjithatë, kjo përpjekje e shpatarakëve përfundoi pa sukses.

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe mbajtjes së Konferencës së Ambasadorëve në Londër, Fuqitë e Mëdha vendosën në vija të përgjithshme kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë, kurse caktimin e kufirit në vend do ta bënte një Komision i Kufijve, i cili ishte formuar gjatë zhvillimit të punimeve të Konferencës. Ky Komision u përball me mjaft vështirësi, të cilat i shkaktonte qeveria greke. Ajo përdori çdo mjet të mundshëm për të fituar sa më shumë territore. Nëpërmjet kërcënimeve ata e detyronin popullsinë shqiptare të largohej nga vendet në të cilat do të kalonte komisioni, organizonin “*mitingje*” duke kërkuar bashkim me Greqinë të territoreve që Konferenca ia kishte njohur Shqipërisë. Në këto “*mitingje*”, me porosi të qeverisë greke zakonisht merrnin pjesë ushtarë grekë të veshur me veshje civile. Këta gjithashtu ushtronin terror mbi popullsinë shqiptare, duke e detyruar atë që t'i lyente muret e shtëpive me ngjyrat bardhë e kaltër, ato të flamurit grek, për të krijuar përshtypjen te

⁴³ Stavro Skendi, *Zgjimi kombëtar shqiptar 1878-1912*, PHOENIX & Shtëpia e librit dhe komunikimit, 2000, 272.

anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve se banorët e tyre ishte grekë.⁴⁴

Një metodë tjetër që përdornin grekët në zonat e pretenduara ishte se ua ndalonin banorëve të komunikonin në gjuhën shqipe. Nëse ndodhte që ata të takoheshin me anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve, kush dinte greqisht do të fliste në atë gjuhë, por në asnjë rast nuk guxonin të flisnin në gjuhën shqipe. Në tetor 1913, anëtari austro-hungarez i Komisionit, Bilinski (Biliński), u propozoi kolegëve të tij që të bënin një shëtitje në qytet. Kur hynë në oborrin e shkollës greke ai hodhi në mesin e fëmijëve që luanin një grusht monedha. Ata vrapuan se cili të merrte sa më tepër për vete dhe nga hutimi harruan porosinë e mësuesve për të mos biseduar në gjuhën e ndaluar. Në vend të greqishtes folën në gjuhën shqipe, të cilën e kishin gjuhë amtare. Kjo ishte e e mjaftueshme për Komisionin të bindej për përkatësinë kombëtare të fëmijëve dhe të popullsisë.⁴⁵

Mësuesja Elpinike Frashëri ka përshkruar situatën në fshatin e saj, i cili ndodhej në afërsi të Përmetit. Sipas saj, ndonëse nuk kishte asnjë grek në popullsinë e Përmetit, kisha dëshironte që t'i bënte të ndjeheshin grekë. Çdo ditë pyetja e parë që i bëhej secilit në shkollë ishte: “Çfarë je ti?” dhe përgjigja ishte: “Unë jam një i krishterë ortodoks grek”. Ajo përshkruan situatën e vet edhe pas emigrimit drejt Amerikës, atje ku flitej anglisht por asaj i ishte ngulitur ideja se gjithkund duhej të kishte një gjuhë amtare (në rastin e saj shqip) dhe një gjuhë shkolle (greqisht) dhe e kishte të vështirë të mësohej me faktin se atje njerëzit flisnin të njëjtën gjuhë në familje dhe në shkollë.⁴⁶ Politika asimiluese e Greqisë vazhdoi edhe gjatë gjithë periudhës së shek. XX. Popullsia çame iu nënshtrua një persekutimi të vazhdueshëm nga ana e autoriteteve shtetërore greke. Ata që mbetën në Greqi u asimiluan, kurse një pjesë tjetër u detyrua të shpërngulet.

⁴⁴ *Historia e Popullit Shqiptar III-Periudha e Pavarësisë 28 Nëntor 1912-7 prill 1939*, Toena, Tiranë 2007, 52; Shih dhe: *Aubrey Herbert dhe krijimi i Shqipërisë së sotme-Ditar dhe letra 1904-1923*, Artini, Prishtinë 2020, 275, 311; *Histori e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Siprint, Prizren 2001, 178.

⁴⁵ Edwin Jacques, *Shqiptarët - Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët tona*, Kartë e Pendë, Tiranë 1995, 375-376.

⁴⁶ Po aty, 376.

Propaganda bullgare

Bullgarët u bënë faktor i rëndësishëm në skenën politike të Ballkanit në vitet '70-të* të shek. XIX, kur fillimisht fituan pavarësi fetare dhe më pas, me ndihmën e Ruisë krijuan edhe dy shtete autonome*. Në vitin 1870 bullgarët arritën të fitonin kishën e tyre të pavarur. Deri në atë kohë, në aspektin fetar ata ishin të varur nga Patrikana e Stambollit. Nga mesi i shek. XIX, nacionalistët bullgarë dolën me kërkesën për pavarësi fetare nga Stambolli. Qëllimi i tyre ishte që t'i jepnin fund propagandës greke në territoret e tyre. Madje ata arritën deri aty sa shqyrtonin edhe mundësinë e bashkimit me kishën romane, me qëllim që të shpëtonin nga presioni grek i Patrikanës së Stambollit. Shpallja e dekretit perandorak nga ana e sulltanit, krijoi Ekzarkatin bullgar, çka u mundësoi atyre pavarësimin fetar.

Bazuar në fermanin e sulltanit, kisha bullgare do të kishte nën kontrollin e saj fetar të gjitha kishat në Bullgari, si dhe ato në krahinën e Velesit dhe të Nishit. Territoret tjera të cilat nuk përmendeshin në ferman mbetën nën varësinë e Patrikanës së Stambollit. Të tilla ishin ato të Shkupit, të Manastirit, të Ohrit, të Shtipit si dhe disa territore në jug të maleve Ballkan, në Rumelinë Lindore dhe në Traki, popullsia e të cilave fliste bullgarisht ose gjuhë të ngjashme me të. Por, ndërmjet viteve 1872 dhe 1875, pjesa më e madhe e vendbanimeve sllave u bashkuan me kishën e re. Kjo ndoshta edhe për faktin se Patrikana i trajtonte famullitë sllave si inferiore dhe shpeshherë nuk i respektonin traditat e tyre fetare gjatë mbajtjes së meshës⁴⁷, çka i shtyri ato të

* Më 29 shkurt të vitit 1870, sulltan Abdylazizi lëshoi fermanin me të cilin themelohej Ekzarkatit bullgar, duke shkëputur kështu ortodoksët bullgarë nga varësia e Patrikanës së Stambollit. Me këtë akt njihej edhe kombësia bullgare dhe vendoseshin themelet e veprimtarisë kombëtare shpirtërore dhe arsimore. Në periudhën 1870-1913, Kisha bullgare themeloi gjithsej 33 dioqeza, prej të cilave vetëm 11 në Bullgari, kurse 22 të tjerat u themeluan në Maqedoni dhe Traki. (Për më tepër shih: Галчев, Илия. 1994. *Здравно-социалната дейност на Българската екзархия в Македонија и Тракија (1870-1913)*. Софија: Јоруков, с. 9, 10).

* Kongresi i Berlinit në vend të Bullgarisë së Madhe të krijuar në Shën Stefan krijoi dy principata bullgare: Principatën e Bullgarisë dhe Principatën e Rumelisë Lindore, të cilat u bashkuan në vitin 1885 dhe krijuan një shtet të përbashkët autonom bullgar, i cili në vitin 1908 u shpall i pavarur.

⁴⁷ Krahaso me: Данкан Пери, *Политиката на теророт-Македонското револуционерно движење 1893-1903*, Магор, с. Скопје 2001, 16.

bashkoheshin me Ekzarkatin*. Në këtë drejtim sigurisht se rol me rëndësi ka luajtur edhe fakti se gjuha e tyre sllave ishte më e afërt me bullgarishten e Ekzarkatit.

Vetëm një pjesë e maqedonasve vazhduan t'i mbeteshin besnikë Patrikanës, kurse pjesa më e madhe iu bashkuan Ekzarkatit. Nga fundi i shek. XIX, sulltani për të thelluar akoma më tepër mosmarrëveshjet midis popujve të Ballkanit, dekretoi themelimin e dioqezave ekzarkiste në Maqedoninë Perëndimore, çka shqetësoi si Patrikanën e Stambollit ashtu edhe atë serbe. Kjo shkaktoi përlëshje të reja midis tri kishave dhe dëmtoi edhe interesat shqiptare. Këta të fundit tani, krahas luftës kundër propagandës greke, duhej të luftonin edhe kundër propagandave serbe dhe bullgare. Brenda një kohe të shkurtër propaganda bullgare depërtoi në brendësi të territoreve shqiptare. Më 1890 bullgarët themeluan një shkollë të tyre në Korçë (për pak kohë), pak më vonë emëruan një episkop ekzarkist në Dibër.⁴⁸

Periudha që pasoi u karakterizua nga lufta midis grupeve të armatosura të cilat sponsorizoheshin nga shtetet përkatëse. Serbia, Greqia dhe Bullgaria arritën të shtrinin dhe fuqizonin ndikimin e tyre në territoret osmane. Secila prej tyre propagandonte se angazhohej për “çlirimin e vëllezërve të krishterë” nga sundimi i Perandorisë Osmane e cila ishte e besimit islam. Në të vërtetë, asnjëri nga vendet ballkanike nuk synonte të çlironte të krishterët, veçse priste rastin e përshtatshëm për t'i aneksuar territoret e tyre. Pushtimi i territoreve shqiptare dhe maqedonase kishte rëndësi strategjike, pasi përmes tyre kalonin rrugët nga lumi Danub drejt deteve Egje dhe Adriatik dhe pastaj drejt Lindjes së Afërt.⁴⁹ Kush do të zotëronte pjesën më të

* Më 16 shtator të vitit 1872, Patrikana e Stambollit e shpalli Ekzarkatin skizmatik, me çka e rëndoi pozitën e kishës bullgare dhe njëkohësisht e thelloi konfliktin kishtar bullgare-grek. Në këtë rast, kisha serbe mbajti anën e Patrikanës së Stambollit. (Për më tepër shih: *Национално-освободителното движење на македонските и тракийските българи 1878-1944 г.-том 3*, Македонски нааучен институт, с, Софија 1997, 80-82.

⁴⁸ *AIH*, A-IV-154, Timo Dilo, *Shqipëria në vitet e fundit të shek. XIX*, Kap. XVI-1229-C, 15.

⁴⁹ Krahaso: Edith Durham, *20 vjet ngatërresa...*, 98; *Historia e Popullit Shqiptar II...*, 256; Charls & Barbara Jelavish, *Themelimi i Shteteve...*, 192; Misha Glenny, *Histori e Ballkanit...*, 157; Mark Mazower, *Ballkani - një histori...*, 107.

madhe të këtyre territoreve do të ishte shteti më i fuqishëm në Gadishullin Ballkanik.

Në vitet e '90-të të shek. XIX, rivaliteti midis vendeve ballkanike për dominim në territoret osmane arriti një shkallë të lartë. Krahas propagandës që zhvillonin nëpërmjet kishës dhe shkollës, ato formuan edhe çeta të armatosura, të cilat ushtruan terror mbi popullsinë civile.

Grekët, serbët dhe bullgarët zhvillonin luftë midis tyre për të fituar besnikërinë e fshatarëve ortodoksë sllavë. Qeveritë e këtyre vendeve hapën dhe financuan shkolla për të propaganduar idealet e tyre kombëtare, ngritën kisha të drejtuara nga peshkopët e tyre; botuan harta dhe kryen "*studime*" etnografike për të mbështetur pohimet e tyre. Ata synonin që nëpërmjet botimeve, të bindnin si opinionin e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm se pretendimet e tyre mbi ato territore ishin të ligjshme. Prandaj, nuk ishte e rastësishme që shpeshherë publikimet e autorëve të këtyre vendeve përmbanin mjaft të pavërteta për popullsinë e territoreve osmane. Vendet ballkanike financuan edhe grupet e armatosura për të ushtruar presion mbi fshatarësinë, kur metodat paqësore nuk ishin të suksesshme. Madje, në çështjet ballkanike filloi të përfshihet edhe qeveria e Bukureshtit. Rumunët nisën të zhvillonin propagandën e tyre në Maqedoni⁵⁰, për të vërtetuar se një pjesë e popullsisë së saj ishte vllahe dhe se ata ishin vëllezërit e tyre.

Rritja e propagandave të shteteve ballkanike çoi në themelimin e dy organizatave revolucionare, siç ishin: "*Organizata e Brendshme Revolucionare*" (në Selanik), programi i saj parashikonte realizimin e "*... autonomisë së plotë të Maqedonisë*" dhe *Komiteti Suprem Maqedonas-Edrenas* (në Sofje), i cili filloi të dërgonte çeta në territoret osmane, të banuara kryesisht nga popullsia sllavishtfolëse. Në anën tjetër u formuan çetat greke, të cilat kishin përkrahjen e qeverisë së Athinës dhe të Patrikanës së Stambollit, ku të njëjtën gjë e bënë dhe serbët. Këto grupe luftonin kundër osmanëve, por njëkohësisht edhe kundër njëri-tjetrit "*për çlirimin e Maqedonisë*".⁵¹

⁵⁰ Mark Mazower, *Ballkani-një histori...*, 107-108.

⁵¹ AIH, A-IV-154, Timo Dilo, *Shqipëria në vitet e fundit të shek. XIX*, Kap. XVI-1229-C, 16; Shih dhe Kristaq Prifti, *Lidhja Shqiptare e Pejës. Lëvizja Kombëtare 1896-1900*, ASHRPSSH, Tiranë 1984, 109, 111; Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar - Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Përpjekja, Tiranë 2009, 303.

Bullgarët dërgonin grupe të armatosura në Maqedoni për të terrorizuar banorët dhe për të vrarë turqit. Në të njëjtin grup me turqit përfshiheshin edhe shqiptarët myslimanë, të cilët për shkak të fesë së përbashkët konsideroheshin të njëjtë me osmanët. Ata shpresonin se reprezaljet do ta detyronin popullsinë të ngrihej në revoltë.⁵²

Qëllimi i krerëve të çetave bullgare ishte të provokonin pushtetin osman që të përdorte dhunë kundër popullsisë, çka do të shkaktonte reagimin e opinionit evropian dhe kjo të tërhiqte vëmendjen e Fuqive të Mëdha. Ndërhyrja e jashtme konsiderohej e domosdoshme për arritjen e objektivave kombëtare nga shtetet ballkanike. Veprimtaria e komiteteve revolucionare bullgare dhe programet e tyre për aneksimin e Maqedonisë ose për autonominë e saj u kundërshtuan nga nacionalitetet tjera të kësaj krahine. Për këta të fundit aneksimi ishte vetëm ndërrim i sunduesit. Gjithashtu edhe kërkesa për autonomi konsiderohej e rrezikshme pasi ajo shihej si një etapë e përkohshme drejt aneksimit nga ana e Bullgarisë, ashtu siç kishte ndodhur me Rumelinë Lindore. Megjithatë, këto dyshime dolën të ishin të pabaza, pasi lëvizja iu përmbajt me besnikëri programit autonomist, deri në shpalljen e Hyrijetit (Kushtetutës osmane), më 1908. Përveç kësaj kufijtë e Maqedonisë nuk ishin caktuar ndonjëherë. Askush nuk e dinte ku fillonin e ku mbaronin ato. Madje, Ismail Qemali deklaronte se Maqedonia* ishte një shprehje gjeografike dhe asgjë tjetër.⁵³

⁵² Shih: Charls & Barbara Jelavish, *Themelimi i Shteteve...*, 196.

* Maqedonia nuk ekzistonte si njësi e veçantë administrativo-territoriale e Perandorisë Osmane dhe për më tepër ishte e banuar nga etni të ndryshme. Ishte rajon multikulturor, ku shumicën e popullsisë e përbënin sllavët, shqiptarët, grekët, si dhe turqit, vllahët, hebrenjtë etj. Ishte territor me kufij të papërcaktuar qartë. I ringjallur në mesin e shek. XIX, emri Maqedoni vinte nga periudha e antikitetit (shek. IV p. e. s.). Në periudhën e mesjetës dhe gjatë sundimit osman, ky term përdorej vetëm si shprehje gjeografike për shkak të traditës historike. Por, në periudhën e fundit të shek. XIX, kur u bë e qartë se Perandoria Osmane do ta humbe kontrollin e saj mbi këtë territor, atëherë secila nga shtetet ballkanike do të angazhohen që ta paraqesin atë si pjesë të trungut historik kombëtar. (Për më tepër: *Historia e Popullit Shqiptar II...*, 257; Kristaq Prifti, *Popullsia e Kosovës 1831-1912*, ASHSH, Tiranë 2014, 36; Kristaq Prifti, *Lidhja Shqiptare e Pejës...*, 108-109; Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, vëllimi I, (1867-1912)*, 8 Nëntori, Tiranë 1984, 54; Mark Mazower, *Ballkani-një histori...*, 107; Misha Glenny, *Histori e Ballkanit...*, 157).

⁵³ *AIH*, A-IV-154, Timo Dilo, *Shqipëria në vitet e fundit të shek. XIX*, Kap. XVI-1229-C, 26.

Në dhjetëvjeçarin e parë të shek. XX, dhuna në territoret ballkanike të Perandorisë Osmane mori përmasa të gjera. Veprimtaria e bandave u gjallërua. Fshatarët detyroheshin shpesh të ndërronin përkatësinë e tyre etnike ose kishtarë. Në disa raste përdorej paraja e në shumë të tjera dhuna. Shtëpitë “*armiçësore*” dhe fshatra të tëra u dogjën⁵⁴. Një shqiptar pronar tokash nga Lenishta ishte therur në grykë⁵⁵, faji i vetëm i të cilit ishte se përkatësia etnike e tij ishte e ndryshme nga ajo e bandave që kontrollonin vendbanimin e tij. Në fillim të shek. XIX, dhuna në Maqedoni mori karakter masiv. Vetëm në vitet 1903-1906, në Maqedoninë e 1.5 milion banorëve u vranë 10 000 njerëz.⁵⁶

Në kuadër të luftës për dominim në territoret osmane në Ballkan, u dëmtua edhe çështja shqiptare. Qendra të propagandës së Ekzarkatit bullgar u bënë Ohri dhe Dibra. Gazeta *Drita* kundërshtonte politikën që qeveria osmane zhvillonte ndaj kishës bullgare. Në janar dhe në prill të vitit 1902, kjo gazetë akuzonte qeverinë e Stambollit se po i lejonte bullgarët të zhvillonin propagandën e tyre në territoret shqiptare. Ekzarkati kishte siguruar nga Porta të drejtën për themelimin e shkollave në gjuhën bullgare në Dibër e Tetovë, “*ku nuk flitet asnjë fjalë bullgarisht*”, me qëllim që t’i kthente shqiptarët në sllavë⁵⁷.

Karakterin shqiptar të territoreve veriore dhe perëndimore të Maqedonisë së sotme e njihnin edhe udhëpërshkrues dhe studiues të kohës. Në vitin 1903, Baldacci shkruante “*pjesa veriperëndimore e Maqedonisë ka qenë shqiptare, ku ende sot popullsia shqiptare është absolute në krahasim me të tjerat*”. As propagandat e vazhdueshme bullgare dhe serbe nëpërmjet kishave dhe shkollave nuk kishin arritur ta asimilonin plotësisht popullsinë ortodokse shqiptare në territoret ku ajo ishte shtrirë*. Po atë kohë, studiuesi italian shprehej se “*Maqedonia perëndimore nuk ka qenë dhe nuk është bullgare. Pjesët e bullgarizuara atje janë rezultat i sundimit mesjetar bullgar dhe pas vitit 1878 të propagandës aktive fetare dhe gjuhësore të komiteteve*

⁵⁴ Mark Mazower, *Selaniku qyteti i fantazmave*, Dituria, Tiranë 2011, 349.

⁵⁵ Misha Glenny, *Histori e Ballkanit...*, 202.

⁵⁶ Daut Dauti, *Britania dhe çështja shqiptare gjatë rënies së Perandorisë Otomane 1876-1914*, Shkup: Logos-A, 2020, 150.

⁵⁷ Stavro Skendi, *Zgjimi kombëtar shqiptar...*, 270.

* Me vendimin nr. 6/15, të Gjykatës Themelore Shkup II, të datës 1 dhjetor 2015, themelohet Bashkësia Fetare e Shqiptarëve Ortodoks në Republikën e Maqedonisë.

bullgare, të lidhura me pansllavizmin".⁵⁸ Megjithëse propaganda bullgare kishte pasur efektet e saj, prapëseprapë nuk kishte arritur rezultate të mëdha për asimilimin e shqiptarëve ortodoksë. Bullgarët, serbët dhe grekët e kishin më të vështirë t'i asimilonin shqiptarët e krishterë për faktin se shqiptarët flisnin një gjuhë e cila ishte krejtësisht e ndryshme nga gjuhët e secilit prej këtyre kombeve. Bullgarët dhe serbët shumë më lehtë mund t'i bënin për vete sllavët e Maqedonisë, me të cilët flisnin gjuhë të ngjashme, por jo edhe shqiptarët. Shqipja nuk kishte asnjë element të përbashkët me bullgarishten, serbishten apo greqishten. Gjuha ishte faktori kryesor që i shpëtoi një pjesë të shqiptarëve nga asimilimi. Ajo pjesë e shqiptarëve që u asimiluan nga serbët, grekët dhe pjesërisht nga bullgarët, kjo ndodhi për shkak të presionit tepër të madh që ushtrohej mbi ta nëpërmjet kishës, shkollës dhe bandave të armatosura.

Meqenëse bullgarët përballeshin në vazhdimësi me rivalitetin serb për dominim në rajonin e Maqedonisë së sotme, qeveria e Sofjes bëri përpjekje maksimale për të tërhequr sa më shumë nxënës në shkollat e saj. Në Kumanovë, prindërit preferonin më shumë shkollat serbe sesa ato bullgare. Prandaj, për ta luftuar dominimin serb në shkolla, bullgarët emëruan, në nëntor 1908, Anastas Albanskin (Arnaudovin) mësues në Kumanovë. Meqë Anastasi shqipen e kishte gjuhë amtare, mendohej se ai mund të tërhiqte më shumë nxënës shqiptarë në shkollën bullgare⁵⁹ dhe kështu propaganda bullgare do të avanconte para asaj serbe në atë rajon.

Në mjaft raste shkolla dhe kisha kishin luajtur rolin e tyre në asimilimin e popullsisë ortodokse shqiptare. Zakonisht, në territoret që ndodheshin më në afërsi të qendrave të propagandës asimilimi ishte më i madh. Popullsia e krishterë e një fshati të fushëgropës së Shkupit, megjithëse fliste gjuhën shqipe, deklarohet bullgare.⁶⁰ Prifti ortodoks kishte ndikuar në këtë drejtim. Në këtë rast, prifti ishte i emëruar nga qeveria e Sofjes dhe për rrjedhojë ai e ndihmonte politikën e saj në atë rajon. Asimilimi i shqiptarëve ortodoksë fillonte me burrat të cilët e mësonin gjuhën serbe, bullgare ose greke dhe pastaj zgjerohej brenda familjeve. Serbët në veri, grekët në jug dhe bullgarët në lindje, kishin

⁵⁸ Antonio Baldacci, *Shqipëria e Madhe*, Uegen, Tiranë 2006, 60, 74.

⁵⁹ Avzi Mustafa, Anastas Albanski (Arnaudov) mësues nga Reka e Epërme. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*, UEJL, Gostivar-Shkup 2014, 72.

⁶⁰ Mid'hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, 2..., 238.

arritur të asimilonin numër të konsiderueshëm të shqiptarëve ortodoksë. Madje, shpeshherë në regjistrimet e kohës llogariteshin si sllavë ose grekë edhe shqiptarët të cilët kishin arritur ta ruanin identitetin e tyre kombëtar. Në 25 fshatrat e Rekës në Dibër, popullsia ortodokse, fliste vetëm shqip dhe e konsideronte veten si të tillë⁶¹, por pavarësisht këtij fakti, shpesh ajo konsiderohej si serbe, greke ose bullgare, varësisht se kush i publikonte statistikat. Albanologu bullgar, Anton Pançev, thekson se pavarësisht se ajo popullsi e njëjte bullgarishten, ata ishin shqiptarë. Kur flet për popullsinë e atij rajoni ai vë në dukje se më shumë se gjysma e popullsisë ishte ortodokse. “*Fshatrat e Rekës të cilët kanë qenë në kontakt me katundet bullgare, e kanë ditur mirë edhe gjuhën bullgare*”.⁶² Në sanxhakun e Dibrës rreth 20 000 ishin ortodoksë shqiptarë.⁶³

“Jehona e Bullgarisë”, në njërin prej numrave të saj, në vitin e parë të botimit (1913), në një studim që i ka kushtuar Dibrës, pranonte se “*nën influencën e propagandës aktive të bullgarëve, jo vetëm sllavët e Dibrës, por edhe shqiptarët e krishterë kanë filluar të quhen bullgarë*”. Autori bullgar, Jovan Ivanov (Йордан Иванов. *Българите в Македонија*. Софија, 1915, f. LXIII), thotë se “*në Gostivar, popullsia shqiptare e krishterë që jeton pranë minoritetit bullgar, është bullgarizuar*”.⁶⁴ Asimilimi i shqiptarëve ortodoksë mori përmasa të gjera pas vitit 1912, në territoret e pushtuara nga shtetet ballkanike. Pjesa më e madhe e tyre u greqizuan dhe sllavizuan dhe vetëm një pjesë fare e vogël arriti ta ruante identitetin e saj kombëtar, të cilin nuk guxonte ta shprehte deri pas rënies së regjimit komunist në vitet ‘90-të, të shek. XX.

Gjatë shek. XIX, Perandoria Osmane ishte përfshirë në një krizë të gjithanshme, e cila me kalimin e kohës shprehej gjithnjë e më shumë. Ky dobësim i pandalshëm i Perandorisë Osmane e bëri të qartë se pushtetit të saj gati pesë shekullor në Evropën Juglindore po i vinte fundi. Prandaj edhe politika e jashtme e secilit shtet ballkanik u fokusua në krijimin e kushteve të përshtatshme, që kur të vinte

⁶¹ Krahaso: Mid’hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, 2..., 204; Noel Malcolm, *Kosova-një histori e shkurtër...*, 202.

⁶² Anton Pançev, *Shqiptarët e Rekës në fillim të shekullit XX sipas burimeve bullgare*. Në *Shqiptarët e Rekës së Epërme*, UEJL, Gostivar-Shkup 2014, 51.

⁶³ Sami Frashëri, *Vepra 3 - Viset shqiptare në Kâmûs al-A’lâm*, Logos-A, Shkup 2002, 55.

⁶⁴ Mid’hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, 2..., 204.

momenti i duhur të vepronte dhe secili të sigurate përfitime territoriale nga trashëgimia osmane. Që nga krijimi i tyre si shtete të pavarura (Greqia) apo principatat (Serbia, Mali i Zi dhe më vonë Bullgaria) hartuan projekte hegjemoniste, të cilat në themel të tyre kishin pushtimin e territoreve të huaja. Njëri nga territoret e pretenduara nga vendet ballkanike krahas territoreve shqiptare ishte edhe Maqedonia.

Nga veprimet e bandave serbe, greke dhe bullgare më së shumti vuajti popullsia e pafajshme. Shqiptarët e krishterë terrorizoheshin sepse nuk pranonin të ndryshonin përkatësinë e tyre kombëtare dhe të deklaroheshin serbë, grekë apo bullgarë, kurse ata myslimanë trajtoheshin bashkëfajtorë me turqit për shkak të përkatësisë së tyre fetare. Në të dyja rastet shqiptarët ishin viktime të pafajshme të politikës ekspansioniste të vendeve fqinje.

Dhuna ndaj “*të huajve*” në Ballkan nuk mori fund as me përfundimin e sundimit osman e as me zgjerimin territorial të shteteve ballkanike. Përkundrazi mori dimensione të reja. Ajo do të jetë e pranishme edhe në periudhën në vazhdim dhe do të shfaqet në periudha të ndryshme gjatë shek. XX. Sa herë do t’u jepet rasti, shtetet ballkanike do ta shfrytëzojnë në maksimum mundësinë për të pushtuar territore të huaja, duke përdorur çdo mjet, madje edhe ato të zhdukjes masive të popullsisë tjera.

Të katër shtetet ballkanike i konsideronin shqiptarët të njëjtë me osmanët, për shkak të besimit të përbashkët fetar myslimanë. Prandaj, ashtu siç nuk duhej të kishin mëshirë ndaj turqve po ashtu nuk duhej të kurseheshin as me shqiptarët. Por, gjithashtu për shkak të pretendimeve mbi të njëjtin territor nga dy ose më shumë shtete ballkanike, rivaliteti midis tyre arriti deri në armiqësi të hapur. Ndërsa të gjithë bashkërisht luftonin kundër osmanëve dhe shqiptarëve, njëkohësisht ata do të luftojnë edhe kundër njëri-tjetrit.